

VENDIM
Nr. 920, datë 25.11.2020

PËR TRAJTIMIN ME PAGË E SHITESA MBI PAGË DHE PËR PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PAGA DHE SHITESAT MBI PAGË

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë, si më poshtë vijon:

a) Paga bazë mujore për gradë, që është niveli i pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës. Vlera e pagës bazë mujore për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që është shtesa për shkak të natyrës së punës, për kohën që ushtrojnë detyrat funksionale (sipas funksioneve/pozicioneve të miratuara në organikë) dhe që përcaktohet:

i. në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

ii. në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e Policisë së Burgjeve në aparatën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

c) Shtesa për vjetërsi në shërbim, që është shtesa që përfiton punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Llogaritja e shtesës për vjetërsi shërbimi bëhet mbi pagën e gradës “Nëninspektor”, të rolit bazë.

2. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij kreu, konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas ekuivalentimit në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë së shërbimit vetëm për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, të vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa gradë, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

II. KOMPENSIMI PËR SHPENZIMET E UDHËTIMIT

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij, në rast pamundësie të garantimit nga institucioni të transportit nga vendbanimi deri në vendin e punës, përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit.

2. Masa e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas pikës 1 të këtij kreu, përcaktohet në varësi të distancës në kilometra, të vendit të punës me vendbanimin e punonjësit, si më poshtë vijon:

Distanca në kilometra	Masa e kompensimit në lek për muaj
Nga 36 km deri 60 km	3 000 lekë/muaj
Nga 61 km deri 100 km	5 000 lekë/muaj

Nga 101 km deri 150 km	8 000 lekë/muaj
Nga 151 km deri 200 km	10 000 lekë/muaj
Mbi 200 km	15 000 lekë/muaj

3. Për përfitimin e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, punonjësi paraqet në institucionin ku është transferuar dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim, pranë institucionit ku është i punësuar punonjësi;
- b) fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) certifikatën e gjendjes familjare;
- ç) vërtetimin nga njësia e vetëqeverisjes vendore, për vendbanimin e familjes dhe të vetë punonjësit, pavarësisht nga gjendja civile;
- d) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi është pronar i një banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar;
- dh) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi ka aplikuar për legalizim banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar.

4. Titullari i njësisë shpenzuese verifikon nëpërmjet strukturave të institucionit vërtetësinë e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, të paraqitur nga punonjësi.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit, në masën dhe sipas rregullave të përcaktuara në këtë krye, deri në momentin e sistemimit me banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

III. KOMPENSIMI PËR QIRANË E BANESËS

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, për shkak të detyrës ose për nevoja pune, kompensohet për qiranë e banesës, në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Këtë kompensim punonjësi e përfiton nëse transferohet ose komandohet në largësi mbi 36 km.

2. Masa e kompensimit për qira banese, për punonjësin e Policisë së Burgjeve sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij kreu, në varësi të personave në ngarkim që ka punonjësi, është, si më poshtë vijon:

Numri i personave në ngarkim	Sipërfaqja e banesës për të cilën i kompensohet qiraja e banimit
I vetëm	43.93 m ²
Punonjësi dhe një person në ngarkim	56.47 m ² ;
Punonjësi dhe dy persona në ngarkim	79.74 m ² ;
Punonjësi dhe tre persona e më shumë, në ngarkim	80.50 m ² .

3. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Policisë së Burgjeve, vërtetohet nëpërmjet certifikatës së gjendjes familjare.

4. Njësia shpenzuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve bën kompensimin e qirasë së banesës së punonjësit të Policisë së Burgjeve, përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore. Vlera minimale mujore e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira do të përllogaritet në bazë të vlerës mesatare të shitblerjeve së banesave në tregun e lirë, sipas njësive administrative, të përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

5. Për përfitimin e kompensimit për qira banese, sipas pikave 1 deri në 4, të këtij kreu, punonjësi paraqet në institucionin ku është transferuar, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim, pranë njësisë buxhetore ku është i punësuar;
- b) fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) certifikatën e gjendjes familjare;
- ç) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku punonjësi është transferuar ose komanduar;
- d) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që punonjësi nuk ka banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar;

dh) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që punonjësi nuk ka aplikuar për legalizim banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar.

6. Titullari i njësisë shpenzuese verifikon, nëpërmjet strukturave të varësisë, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi dhe zbatimin e kontratës së qirasë.

7. Përcaktimi i apartamentit të banimit, që punonjësi i Policisë së Burgjeve do të marrë me qira, si dhe i masës së pagesës së qirasë, sipas përcaktimeve në këtë krye, bëhet nga një komision vlerësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, i cili përzgjedh ofertën më të leverdisshme, mbi bazën e shqyrtimit të 3 (tre) ofertave të marra nga ky punonjës, nga 3 (tre) shoqëri imobiliare.

8. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, pasi merr miratimin për ofertën e përzgjedhur, sipas përcaktimit në pikën 7, të këtij kreu, nënshkruan kontratën e qirasë së apartamentit të banimit për një periudhë 6-mujore, me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtat kushte. Kontrata e qirasë, detyrimisht, duhet të bëhet në një zyrë noteriale.

9. Procedurat standarde të punës për verifikimin e vërtetësisë së dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, të lidhjes dhe zbatimit të kontratës së qirasë dhe pagesës së qirasë së banesës, sipas përcaktimeve të këtij kreu, miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

10. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, që përfiton kompensim për qiranë e banesës, nuk përfiton kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

11. Fondi i përcaktuar për kompensimin e qirave të banesave, sipas parashikimeve të këtij kreu, planifikohet çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Burgjeve.

12. Përfitimi i kompensimit për qiranë e banesës vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit, që nënkupton sistemin me banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

IV. TRAJTIMI ME USHQIM PA PAGESË OSE KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË USHQIMIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i siguron punonjësit të Policisë së Burgjeve, në rastet kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit, trajtimin me ushqim pa pagesë:

- a) me një vakt, kur kohëzgjatja e punës së punonjësve të Policisë së Burgjeve është 8 (tetë) orë;
- b) me tri vakte, kur punonjësit e Policisë së Burgjeve janë të angazhuar në shërbime apo gatishmëri dhe kohëzgjatja e shërbimit ose e gatishmërisë zgjat 24 (njëzet e katër) orë.

2. Normat e ushqimit ditor të kalorive, për të gjithë punonjësit përfitues sipas pikës 1, të këtij kreu, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për policinë e burgjeve dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ku përcaktohen:

- a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;
- b) normat e zëvendësimit të artikujve ushqimorë;
- c) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.

3. Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk siguron trajtimin me ushqim pa pagesë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, punonjësit të Policisë së Burgjeve i jepet një kompensim në vlerë monetare për shpenzimet e ushqimit, për ditët efektive të punës. Vlera e

kompensimit (në lek) të shpenzimeve të ushqimit, bëhet bazuar në normën e përcaktuar ushqimore, dhe miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton trajtimin me ushqim pa pagesë apo kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, sipas këtij kreu, deri në momentin e sistemit me banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

5. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Burgjeve.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për Policinë e Burgjeve dhe fillojnë:

- a) për parashikimet e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, nga data 7 gusht 2020;
- b) për aplikimin e shtesës për vjetërsi shërbimi, për çdo vit të qëndrimit në gradë, nga data 1 janar 2021;
- c) për zbatimin e shtesave për natyrë të veçantë pune, sipas lidhjeve nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, nga data 1 janar 2022.

2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, deri në datën 1 janar 2022, do të vazhdojnë të përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune e shërbimi sipas përcaktimit në vendimin nr. 201, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 201, datë 15.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të policisë së burgjeve”, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA BAZË MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3
Bazë	Aspirant	40000
	Nëninspektor	45500
	Inspektor	50000
	Kryeinspektor	55000
I mesëm	Nënkomisar	65500
	Komisar	72000
	Kryekomisar	95000
I lartë	Drejtues	106700
	Drejtues i Lartë	115000

SHTESA PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE, PËR KOHËN QË USHTROJNË DETYRAT FUNKSIONALE (SIPAS FUNKSIONEVE/POZICIONEVE TË MIRATUARA NË ORGANIKË) NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Roli	Grada	Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune, sipas funksioneve organike në funksione të Policisë së Burgjeve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)						
		Shefi i Policisë dhe Grupi Sigurisë		Regjimi i brendshëm		Regjimi i jashtëm		Regjimi i posaçëm
		Shefi i Policisë		Specialist regjimi Specialist policie		Specialist regjimi		Specialist regjimi
		Specialist i Grupit të shoqërimit dhe sigurisë		Përgjegjës shërbimi në godinë		Specialist informacioni		Përgjegjës shërbimi
		Grupi i Sigurisë dhe Shoqërimeve		Përgjegjës shërbimi në ambientet e takimeve. Shoqërues takimesh dhe të dënuarish		Ndihmëspecialist informacioni		Punonjës i regjimit të brendshëm. Grupi i forcave speciale
				PRB në vendshërbime		Përgjegjës shërbimi në regjim		Përgjegjës i sektorit të forcave speciale dhe specialist i forcave speciale
				Teknik operator dhe për kamerat		PRB në vendshërbime Operator kamerash Kontrollor për familjarët dhe ushqimet		
				Shoqërues për familjarët				
		Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale						
		Burgje të Sigurisë së Lartë	Burgje të Sigurisë së zakonshme dhe paraburgimet	Burgje të Sigurisë së Lartë	Burgje të Sigurisë së zakonshme dhe paraburgimet	Burgje të Sigurisë së Lartë	Burgje të Sigurisë së zakonshme dhe paraburgimet	IEVP me regjim të posaçëm dhe forcat speciale
Bazë	Aspirant	12000	10000	10000	9000	6000	5000	
	Nëninspektor	12000	10000	10000	9000	6000	5000	15000
	Inspektor	12000	10000	10000	9000	6000	5000	15000
	Kryeinspektor	12000	10000	10000	9000	6000	5000	15000
I mesëm	Nënkomisar	12000	10000	10000	9000	6000	5000	15000
	Komisar	12000	10000	10000	9000	6000	5000	15000
	Kryekomisar	12000	10000					

SHTESA PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE, PËR KOHËN QË USHTROJNË DETYRAT FUNKSIONALE (SIPAS FUNKSIONEVE/POZICIONEVE TË MIRATUARA NË ORGANIKË) NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

		Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune sipas funksioneve organike në funksione të Policisë së Burgjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve				
Roli	Grada	Drejtori i Policisë së Burgjeve	Përgjegjës i Sektorit të Paraburgimit dhe Burgjeve Përgjegjës i Sektorit të Forcave Operacionale Përgjegjës i Qendrës së Trajnimit Përgjegjës i Sektorit të Informacionit Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit.	Forcat Speciale të Regjimit të Posaçëm.	Përgjegjës i Grupeve në Gjykatë PRB të Grupit Operacional dhe drejtues mjeti PRB të Grupit të Gjykatave Përgjegjës i Grupeve të Forcave Operacionale (PRB)	Specialist policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në të gjithë sektorët, si dhe punonjës të rolit bazë Ndihmësspecialist i Sektorit të Informacionit PRB të Grupit të Objekteve PRB teknik i Sektorit të Analizës dhe Monitorimit Specialist i Trajnimit. Specialist Policie i Forcave Operacionale
				Përgjegjës i sektorit të Forcave Speciale Specialist i Sektorit të Forcave Speciale dhe specialist i Forcave Speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve		
				Forcat operacionale speciale		
1	2	3	4	5	6	7
Bazë	Aspirant					
	Nëninspektor					6000
	Inspektor			15000	10000	6000
	Kryeinspektor			15000	10000	6000
I mesëm	Nënkomisar					
	Komisar			15000		
	Kryekomisar			15000		6000
I lartë	Drejtues		9000			
	Drejtues i Lartë	10000				

